



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

Nr. 390/3 prot.

Tiranë, më 10.07.2023

### VENDIM

Nr. 6, datë 10.07.2023

## I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË AKSIONERE

### REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 SH.A.

Mbështetur në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, në ligjin Nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, në ligjin Nr.1009, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.335, date 04.05.2016, “Për transferimin e 100% të aksioneve të Shoqërive Aksionere “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sh.a Tiranë, “Trajtimi i Studentëve Nr.2” Sh.a Tiranë, dhe “Trajtimi i Studentëve Nr.3 Sh.a Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë”, Vendimin Nr.3, datë 31.03.2023, të Asamblesë së Përgjithshme “Emërimin si auditues ligjor të autorizuar të shoqërisë “Crowe” shpk, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2022, si dhe evidentimin e zvogelimit të kapitalit nga humbja e mbartur”, “Raportin Ekonomiko-Financiar për Pasqyrat Financiare të vitit 2022” të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Statutin e Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1”sha.

Sot, më datë 10.07.2023, në ambjentet e Bashkisë Tiranë u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

- 1- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, të përgatitura sipas Standarteve të Raportimit Financiar.
- 2- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2022, të hartuar nga “Crowe” sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K.
- 3- Njohjen, miratimin e humbjes së krijuar nga aktiviteti i shoqërisë për vitin 2022 në shumën 50,202,728 lekë.

- 4- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e raportit mbi zvogëlimin e kapitalit të hartuar nga Crowe” sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K, në zbatim të vendimit Nr.3, datë 31.03.2023 të Asamblesë së Përgjithshme.

DUKE QENË SE:

1. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Bashkia Tiranë, zotëruese e aksioneve në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë, duke krijuar kuorumin e nevojshëm për mbajtjen dhe vendosjen në këtë mbledhje.

2.Në përputhje me Statutin e Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve ka kompetencë të miratojë Pasqyrat Financiare të Shoqërisë, Raportin e Audituesit Ligjor për pasqyrat financiare, si dhe raportin e evidentimin e zvogëlimin e kapitalit nga humbja e mbartur.

3.Asambleja e Përgjithshme mbahet dhe vendos në lidhje me çështjet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Aktet e Themelimit të Shoqërisë.

4.Nënshkruesi në emër të Aksionerit ka autorizimin dhe kompetencën e nevojshme për të nënshkruar dhe ekzekutuar këtë Vendim me shkrim.

Proçedohet me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës:

Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, të përgatitura sipas Standarteve të Raportimit Financiar.

Proçedohet me diskutimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2022, të hartuar nga “Crowe” sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K

Proçedohet me diskutimin e pikës së tretë të rendit të ditës:

Njohjen, miratimin e humbjes së krijuar nga aktiviteti i shoqërisë për vitin 2022 në shumën 50,202,728 lekë.

Proçedohet me diskutimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Njohjen, miratimin dhe depozitimin e raportit mbi zvogëlimin e kapitalit të hartuar nga Crowe” sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K, në zbatim të vendimit Nr.3, datë 31.03.2023 të Asamblesë së Përgjithshme.

Për këto arsye, pas diskutimit të rendit të ditës dhe duke mos patur pika të tjera për të diskutuar dhe vendosur, Aksioneri i Vetëm i Shoqërisë.



## VENDOSI:

- 1- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, të përgatitura sipas Standarteve të Raportimit Financiar.
- 2- Njohjen, miratimin e humbjes së krijuar nga aktiviteti i shoqërisë për vitin 2022 në shumën 50,202,728 lekë, e cila të mbartet në vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2023.
- 3- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2022, të hartuar nga "Crowe" sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K
- 4- Njohjen, miratimin dhe depozitimin e raportit mbi zvogëlimin e kapitalit të hartuar nga Crowe" sh.p.k me numër identifikimi Nipt K31516059K, në zbatim të vendimit Nr.3, datë 31.03.2023 të Asamblesë së Përgjithshme.
- 5- Të zbatohen rekomandimet e lëna në raport nga Audituesit Ligjor.
- 6- Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë, të ekzekutojë dhe të dorëzojë në emër të shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm për të zbatuar këtë vendim duke përfshirë, por pa u kufizuar në Qendër Kombëtare të Biznesit dhe/ose para çdo autoriteti tjetër kompetent, siç kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm shqiptar.

AKSIONARI I VETËM

BASHKIA TIRANË

ERION VELIAJ

KRYETAR

